



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

---

**ADGJA.nr.3/2025**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës A.Z. nga P..., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, M.N., në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 21.02.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës A.Z. nga P..., ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, M.N.

**A r s y e t i m**

Me datën 24.01.2025, nga kryesuesi i Këshillit Gjyqësor i Kosovës (KGJK), kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, e ka pranuar një njoftim/ankesë në raport me gjyqtarin e kësaj gjykate M.N. Në ankesë ka theksuar se me datën 24.01.2025, ka pasur një takim me gjyqtarin M.N. Ka theksuar se gjyqtari M.N., i është drejtuar sepse është ofenduar në mbledhjen e Këshillit, me paralajmërim me ton kërcënues dhe përplasje të dyerve (zhurmë e cila është dëgjuar në ambientet e KGJK, se “në qoftë se nuk kërkon falje në mbledhjen e radhës për ofendimin e pretenduar”, i njëjti do të bëjë konferencë për media. Tutje ka shtuar se gjyqtari N... ka deklaruar se ka performancë të shkëlqyeshme por njëkohësisht e ka akuzuar që “ unë e kam qit (caktuar) në Divizionin Civil në Gjykatën e Apelit, sepse ai në fakt është gjyqtar i profilizuar në penale”. Tutje ka shtuar se i njëjti i ka kërkuar gjyqtarit N... që të ulet dhe të dhe të diskutojnë për shqetësimet e tij, duke ja rikonfirmuar që si Kryesues i KGJK, nuk ka asnjë arsye për kërkim falje.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit dhe vlerësimit të njoftimit/ankesës, me datë 24.01.2025, nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, ka kërkuar deklaram të gjyqtarit M.N., lidhur me këtë njoftim/ankesë të parashtruar nga ankuesi, në këtë rast kryesuesi i KGJK A.Z.

Gjyqtari M.N., ka dhënë deklaratë me datën 10.02.2025, ku ka theksuar se me datë 24.01.2025, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka mbajtur mbledhjen e 341, e cila është udhëhequr nga Kryesuesi A.Z. Në këtë mbledhje pika e fundit ishte shqyrtimi i propozimit të kryetarit të Gjykatës së Apelit, Valon Totaj për emërimin e gjyqtarit M.N., anëtar të rregullt të Panelit për Lirim me Kusht (PLK). Kryesuesi gjatë shqyrtimit të kësaj pike ka deklaruar se gjatë vitit 2024 kanë diskutuar edhe me kryetarin e Gjykatës së Apelit, por edhe me atë të Supremes, për profesionalizmin, transparencën dhe rritjen e integritetit të PLK dhe Këshilli unanimisht refuzoi këtë propozim, duke kërkuar nga Gjykata e Apelit ri delegimin e një emri tjetër për anëtar të PLK. Ka theksuar se pasi e kisha të qartë deklaratën e kryesuesit vendosa ta telefonoj dhe u takuam së bashku. Pas përsëritjes, shpreha shqetësimin tim te kryesuesi, duke kërkuar që deklarata, e cila mua më konsideronte si gjykatës pa integritet profesional, të tërhiqet dhe të kërkohet falje, ngase tashmë kjo deklaratë e bërë publike edhe në portal nuk përbënte shqetësim vetëm për mua, por edhe për familjen time. Ka shtuar se Kryesuesi e bëri të qartë se nuk do të tërhiqet nga ajo që tashmë ka thënë se pastaj ka kërkuar nga i njëjti që të di se cilët janë instrumentet vlerësuese për integritet profesional, duke cekur vlerësimin maksimal që ka nga KGJK si dhe pikët të cilët janë pjesë të punës së tij. Në fund ka theksuar se në atë takim asnjëra nga palët nuk ka pasur tone kërcenuese, shantazhuese apo ofenduese si dhe e respekton vendimin e marrë nga KGJK për refuzim, por nuk mund të mbyllë sytë para përljes së integritetit qoftë profesional apo moral.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, përmes e-mailit, me datën 24.01.2025, nga parashtruesi i ankesës disiplinore z.A.Z., ndër të tjera, ka kërkuar informacion të plotë dhe të detajuar se çka ka ndodhur në rastin konkret dhe deri me datën 21.02.2025, nuk ka pranuar asnjë informatë apo provë shtesë nga parashtruesi i ankesës.

Kryetari i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe deklaratës së gjyqtarit M.N., ka gjetur se:

- ankesa e palës ankuese, është **e pabazuar**.

Pas analizimit të pretendimeve të ofruara nga parashtruesi i ankesës, deklarata e gjyqtarit si dhe shkresave të lëndës, si autoritet kompetent vlerësoj se në rastin konkret nuk ka bazë ligjore për të hapur rast disiplinor ndaj gjyqtarit M.N., ngase nuk kemi një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur ankesa për shkelje disiplinore të kryer nga gjyqtari i Gjykatës së Apelit dhe për me tepër këto pretendime nuk vërtetohen me asnjë provë.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në mënyrë shprehimore në nenin 5, ka paraparë rastet në të cilat konsiderohet se është kryer shkelje disiplinore, e që në rastin konkret rezulton se veprimet e gjyqtarit M.N., të përshkruara nga pala ankuese, nuk kanë konsumuar ndonjë nga shkelje të paraparë me këtë Ligj.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me çështjen e parashtruesit të ankesës, meqë nga provat e shqyrtuara, respektivisht deklaratimet e palës ankuese dhe të gjyqtarit të Gjykatës së Apelit, M.N., nuk është vërtetuar se ky i fundit të ketë bërë as shkelje eventuale të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**ADGJA.nr.3/2025, me datën 21.02.2025**

**Kryetari i Gjykatës**  
**Valon Totaj**

***Vendimi t'i dorëzohet:***

- Parashtruesit të ankesës,
- Gjyqtarit M.N.
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës,